



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

SENATI AKADEMİK



STATUTI

I

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Hyrje

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, është institucioni kryesor publik i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në rrethin jugor të Shqipërisë, me tradita dhe arritje arsimore e shkencore të konsoliduara ndër vite, të njohura dhe të vlerësuara brenda dhe jashtë vendit.

Ky Statut, përmban norma që rregullojnë veprimtarinë e institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi, në garantim të autonomisë universitare dhe lirisë akademike, të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me synim zhvillimin e vazhdueshëm për të qënë të aftë në përballimin e sfidave të kohës.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Personaliteti juridik

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, (shkurt UGJ), është institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendimin e KM-së, Nr.414, datë 12.11.1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik 4-vjeçar.

Universiteti "Eqrem Çabej", është person juridik publik, i njohur me ligj si i tillë, veprimtaria e të cilit bazohet në Kushtetutë, në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në aktet nënligjore për arsimin e lartë, në këtë Statut, në Rregulloret e Brendshme dhe në aktet që dalin në zbatim të tyre.

Universiteti "Eqrem Çabej", si person juridik merr pjesë në veprimtaritë publike, private dhe në qarkullimin civil, brenda ose jashtë vendit, në ushtrim të funksioneve që në realizim të qëllimeve të tij të ligjshme.





Selia e Universitetit është në qytetin e Gjirokastrës.
Stema dhe vula janë sipas anekseve bashkëlidhur.

Neni 2
Qëllimet

UGJ ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme e transparente.

UGJ synon zhvillimin e veprimtarisë së tij brenda sistemit arsimor e të kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u angazhuar në organizma / veprimtari, të përhershme / të përkohshme në fushën përkatëse, brenda ose jashtë vendit

Neni 3
Parimet e funksionimit

UGJ përfshin në programet mësimore e studimore dhe garanton shprehjen e lirë të ideve shkencore, kulturore, politike, sindikale e fetare, duke mos lejuar hallka organizative e aktivitetetë të partive politike e komuniteteve fetare, përvèç atyre me karakter shkencor e përkujtimor.

Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënieve dhe kërkimit shkencor të ndërthurura me standartet dhe arritjet më të mira botërore përgjithesisht, e ato europiane në veçanti.

Personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë ose të pjesshme në procesin e mësimdhënieve apo kërkimit shkencor u garantohet autonomia dhe liria e veprimtarisë në harmoni e pa penguar realizimin e programeve e objektivave të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtij Statuti.

Mundësia e barabartë për kushtet materiale dhe financim të mësimdhënieve dhe kërkimit shkencor, është kriteri themelor në veprimtarinë mësimore e kërkimore.

Mbështetja për diferencime individuale ose grupore, është përjashtim që lejohet nga organi kompetent, në mënyrën e përcaktuar në ligj apo në akte nënligjore, për objektiva të një rëndësie të veçantë, për raste emergjente, për shkak të detyrimeve ndërkombetare ose në mbështetje të talenteve.

UGJ u krijon studentëve kushtet për përvetësimin e dijeve, shprehjen e lirë të mendimit e të organizimit në respektim të ligjit dhe të këtij statuti.

Neni 4
Zhvillimi i veprimtarisë





Veprimitaria e UGJ organizohet dhe realizohet me njësitë përbërëse dhe drejtohet e kontrollohet nga organet dhe autoritetet drejtuese që veprojnë me kompetenca të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, në Statut e në Rregullore të cilat kanë mbështetjen e organizmave këshilluese.

UGJ në përputhje me objektivat e tij, të politikës kulturore, të kërkimit, të mësimdhënies dhe në respektimin e lirisë të seçilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurron me këto projekte në planin kombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor, si dhe në planin ndërkombëtar.

Përfundimi dhe vlerësimi i studimeve dhe kërkimeve shkencore bëhet nga organi përkatës sipas ligjit dhe akteve nënligjore me çertifikata, diploma, dëshmi, tituj dhe grada shkencore, përmrbajtja dhe formatet e të cilave miratohen nga Senati Akademik, në përputhje me udhëzimet e organit kompetent sipas ligjt.

UGJ garanton pjesëmarrjen në votime dhe fshehtësinë e votës në zgjedhjen e organeve të tij.

UGJ vlerëson mënyrën e përdorimit të buxhetit të shpenzuar nga njësitë e tij në përbushjen e detyrave përkatëse, me qëllim ekonomizimin dhe efikasitetin e drejimit të Universitetit, si dhe përpunon e shpall indikatorët për të verifikuar objektivat e vendosura, rezultatet e arritura dhe kostot përkatëse.

Neni 5 Mbrojtja juridike

Të gjitha mjediset (ndërtesa e troje) që shteti i ka dhënë në përdorim UGJ-së, si dhe çdo mënyrë që do t'i jepet në të ardhmen, sipas ligjit gjëzojnë paprekshmërinë e siguruar nga shteti.

Kjo paprekshmëri përfshin moslejimin e ndërhyrjes në mjediset e universitetit apo të përdorimit të tyre nga çdo person fizik e juridik, mosndërhyrjen e pushtetit qendror e vendor dhe të organeve të rendit publik pa kërkesën apo lejen nga Rektori i Universitetit ose personi i autorizuar prej tij.

Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë dhe pa lejen e rektorit.

Për çdo cënim të paprekshmërisë, UGJ-së i lind e drejta e denoncimit të shkeljes dhe kërkesës për ndëshkimin e saj sipas dispozitave ligjore.

KREU II STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 6 Universiteti





Universiteti "Eqrem Çabej" është është institucion publik i arsimit të lartë i cili ka në përbërje tre fakultete, ofron programe studimi për të gjitha ciklet si dhe zhvillon kërkim shkencor bazë e të zbatuar, përfshirë këtu edhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore.

Neni 7 Fakulteti

Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përaferta ose të ndërthurura.

Fakulteti duhet të organizohet nga së paku 3 njësi bazë, ku dy duhet të janë departamente.

Universiteti "Eqrem Çabej" përbëhet nga këto fakultete:

- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës



Fakulteti ofron programe studimi të cikleve të ndryshme dhe miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, sipas propozimeve të njësive bazë, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore.

Fusha specifike e secilës njësi bazë përcaktohet në Rregulloren e Universitetit.

Neni 8 Departamenti

Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përaferta dhe grupon disiplinat mësimore respektive.

Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme/përkohshme kërkimore-shkencore.

Departamenti duhet të ketë në përbërje së paku 7 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë, ku tre prej tyre duhet të kenë grada shkencore/tituj akademik si dhe personel ndihmës akademik.

Disiplinat mësimore, fushat e kërkimit shkencor dhe struktura organizative e secilit departament përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

Departamenti propozon programet e studimit si dhe numrin e studentëve për çdo program në përputhje me kapacitetin akademik dhe infrastrukturor.

Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi duke përzgjedhur studentët fitues të cilët miratohen nga Dekani i Fakultetit.





Neni 9
Njësitë ndihmëse

Njësitë ndihmëse janë laboratorët mësimorë dhe bibliotekat, funksionimi dhe mirëmbajtja e të cilave sigurohet nga personeli ndihmës akademik i departamentit sipas fushës përkatëse.

Organizimi më i hollësishëm i njësive ndihmëse përcaktohet në Rregulloren e Universitetit.

Neni 10
Degët

Universiteti "Eqrem Çabej" ka të drejtë që në përputhje me qëllimet e veta të hapi degë të tija në qytete të tjera të Shqipërisë, të cilat mund të janë njësi kryesore ose njësi bazë si struktura të veçanta por edhe si pjesë përbërëse të njësive të selisë qëndrore.

Dega ofron programe studimi sipas fushave përkatëse, të cilat u nënshtronen procedurave dhe kriterieve të akreditimit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore.

KREU III
ORGANET DREJTUESE



Neni 11
Klasifikimi i organeve drejtuese

Organet drejtuese të Universitetit "Eqrem Çabej" ndahen në :

- organë drejtuese akademike
- organë drejtuese administrative
- organë të tjera

Organet drejtuese akademike përfshijnë senatin akademik si organin më të lartë drejtues, asambljenë e personelit akademik dhe komisionet e përhershme.

Organi i vetëm drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.

Organë të tjera janë Rektorati, Dekanati dhe Këshilli i Etikës.

Neni 12
Rregulla të përgjithshme





Procedurat për thirrjen, diskutimin dhe marrjen e vendimeve në organet drejtuese të UGJ

- së pér aq sa është e mundur janë si më poshtë:

Organit mblidhet në mënyrë periodike të paktën një herë në muaj. Mbledhjet janë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Në mbledhjen e parë miratohet rregullorja e funksionimit dhe zgjidhet Kryetari dhe Sekretari, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe. Drejtuesi i organit kolegjal harton rendin e ditës në bashkëpunim me Sekretarin (n.q.s ka).

Njoftimi për rendin e ditës bashkë me materialet e nevojshme informative, kur duhet t'u dërgohen anëtarëve të organit të paktën një ditë pune para mbledhjes.

Në rast se kërkohet me shkrim nga 1/3 e anëtarëve të organit kolegjal diskutimi i një problemi konkret të një rëndësie të veçantë akademike ose financiare, drejtuesi është i detyruar të futë çështjen në rendin e ditës së mbledhjes të rregullt të radhës ose në rast se çështja është urgjente, në një mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuorumi i pranueshëm për zhvillimin e një mbledhjeje është pjesëmarria e të paktën 50% e anëtarëve të organit kolegjal me të drejtë vote. Në rast se nuk plotësohet ky kuorum mbledhja shtyhet për një datë jo më vonë se pas një javë nga mbledhja e mëparshme dhe kuorumi vlerësohet i pranueshëm pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm.

Për çështjet e rendit të ditës referon drejtuesi i organit, ose anëtarë të tjerë të organit të caktuar nga drejtuesi. Drejtuesi mund të ftojë në mbledhje anëtarë të tjerë të komunitetit akademik për dhënie sqarimesh, të cilët në vijim largohen. Nuk lejohet largimi i anëtarëve të një organi gjatë diskutimit apo votimit të një çështjeje të rendit të ditës. Kjo mund të ndodh pas përfundimit të kësaj procedure dhe pa filluar procedura e një çështjeje tjeter.

Të gjithë anëtarët që marrin pjesë në organe kolegiale kanë për detyrë të jenë prezentë gjatë gjithë kohës së zhvillimit të mbledhjeve të tyre. Mungesa ose largimi nga mbledhja para se ajo të mbarojë lejohet vetëm për shkaqe të rëndësishme të cilat i paraqiten me shkrim ose me një mënyre tjetër drejtuesit të organit kolegjal para ose gjatë zhvillimit të mbledhjes.

Në rast se ka konsensus ose unanimitet midis anëtarëve të një organi që kanë të drejtë vote, propozimet hidhen në votë. Votimi bëhet me ngritjen e dorës. Votim emër për emër bëhet pas vendimit të drejtuesit. Në një rast të tillë votimi kryhet sipas alfabetik. Mënyra e votimit të fshehtë është e detyrueshme në rastin e votimeve nominale ose sa herë që kërkohet nga drejtuesi ose organi kolegjal. Gjatë diskutimit të çdo çështjeje drejtuesi u jep fjalën të gjithë atyre që e kërkojnë. Gjithashu koha e arsyeshme për çdo diskutant caktohet nga drejtuesi. Çdo anëtar e ushtron vetë të drejtën e votës pa pasur të drejtën e delegimit të saj.


Vendimet e organit merren me shumicë të votave të vlefshme të anëtarëve të pranishëm, veç rasteve që caktohen ndryshe me ligj.

Drejtuesi mund të ndërpresë mbledhjen e organit kolegjal për pushime të shkurtra. Në marrëveshje me anëtarët e tjerë të organit mbledhja mund të ndërpritet për një afat kohor më të gjatë, por me kusht që të vazhdojë po atë ditë ose të nesërmen.

Sekretari i organit mban procesverbal për çdo mbledhje. Prosesverbalet mund të vihen në dispozicion të cilidho që ka interes ligjor me miratim të drejtuesit të organit kolegjal përkatës. Prosesverbalit përmban në mënyrë të përbledhur referimet, propozimet, diskutimet dhe me saktësi vendimet e marra.

Në procesverbale duhet t'u përmenden:

1. Vendi dhe koha e mbledhjes së organit kolegjal si dhe karakterizimi i saj nëse është e rregullt apo e jashtëzakonshme.
2. Anëtarët që janë të pranishëm.
3. Anëtarët që mungojnë dhe arsyet e mungesës (nëse është ose jo e justifikuar).
4. Ekzistencë ose jo e kuorumit të domosdoshëm (sipas parimeve në bazë të cilave funksionon organi kolegjal).





5. Çështjet e rendit të ditës dhe referimet përkatëse të lidhura me to.
6. Diskutimet (mundësish sa më analitike), të çdo anëtari që merr fjalën.
7. Forma, rezultatet e votimit dhe vendimet e marra.
8. Mendimet e anëtarëve që përbëjnë pakicën.

Në procesverbale duhet të përmenden edhe personat që ftohen për të referuar për çështje specifike.

Drejtuesin e organit kolegjial në rast mungese të tij e zëvendëson zëvendësuesi i tij (në qoftë se ka).

Sekretarin e organit kolegjial e zëvendëson personi që caktohet me vendim të organit kolegjial.

Neni 13
Senati Akademik



Senati Akademik është organ kolegjial vendimmarrës i UGJ. Ai përcakton politikat e zhvillimit të Universitetit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimitaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mblidhet periodikisht.

Anëtarët e Senatit Akademik të institucioneve të arsimit të lartë zgjidhen nga asambletetë e personelit akademik të njësive kryesore, përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.

Anëtarët e senatit i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.

Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, përfekt përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë në personel akademik me gradën shkencore "Doktor" të marrë brenda vendit dhe në mungesë edhe të kësaj kategorie në personel akademik që është në proces fitimi të kësaj grade dhe në fund kandidatë që kanë një diplomë "Master i shkencave".

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të senatit akademik të UGJ, numri i përfaqësuesve të personelit akademik sipas fakulteteve, numri i përfaqësuesve të studentëve sipas fakulteteve, si dhe raportet e përfaqësimit të tyre përcaktohen në mbledhjen e senatit akademik brenda 1 jave nga fillimi i procesit zgjedhor të rradhës nëse nuk parashikohet ndryshe nga aktet ligjore/nënligjore.

Mandati i anëtarit të Senatit Akademik merr fund:

- me mbarimin e afatit;
- me dorëheqje;
- kur ndërpert marrëdhëniet e punësimit apo studimore me UGJ;
- kur mungon pa arsyё në 6 seanca radhazi mbledhjesh të tij.

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Senatin Akademik. Kur nuk ka të tillë, Rektori thirret zgjedhjet për anëtar të Senatit Akademik.





Në mbledhjen e tij të parë senati akademik zgjedh nënkyetarin e Senatit Akademik, i cili zëvendëson kryetarin në drejtimin e Senatit Akademik në rast mungese të tij.

Senati akademik miraton rregulloren e tij të brendshme të funksionimit si dhe vendllohet përgjithshme brenda të tij sipas fushave më proritare.

Neni 14
Funkcionet e Senatit Akademik



Funkcionet e Senatit Akademik janë:

1. garanton autonominë e institucionit të arsimit të lartë, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
2. propozon planin strategjik të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë;
3. miraton statutin e institucionit të arsimit të lartë me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
4. harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
5. miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në statut;
6. miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
7. propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjeter të arsimit të lartë;
8. miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit të arsimit të lartë mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
9. i propozon Ministrit të Arsimit dhe Sportit hapjen apo mbylljen e programeve të reja në UGJ;
10. i propozon Ministrit të Arsimit dhe Sportit kuotat e pranimeve në UGJ, si dhe tarifat e studimeve;
11. miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
12. miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
13. zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
14. miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
15. garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e arsimit të lartë;
16. krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
17. organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprim-tarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare.





18. përcakton përbajtjen dhe formën e diplomave si dhe të suplementit të diplomës në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
19. vendos për anëtarësimin e Universitetit në shoqata e organizma kombëtare e ndërkombëtare me karakter arsimor;
20. përcakton kriteret e përfshimit të shpërbimit për studentët e shkëlqyer të universitetit;
21. miraton hapjen e filialeve, krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekteve të tjera të shërbimit që ofrohen nga fakultetet;
22. miraton projektet e marrëveshjeve apo kontratave te bashkëpunimit me të tretë, te cilat i nënshkruan Rektori në emër dhe për llogari të Universitetit;
23. ngre komisionin ad hoc me tre anëtarë për verifikimin dhe miratimin e rasteve të largimit nga puna të personelit akademik me kohë të plotë. Rektori nuk mund të jetë anëtarë i këtij komisioni.
24. i propozon bordit te administritimit numrin e administratoreve per nivelet kryesore, dhe baze te universitetit.

Neni 15
Asambleja e personelit akademik

Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore.

Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore në institucionet e arsimit të lartë ka këto funksione:


- a) zgjedh rektorin e institucionit në institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) zgjedh anëtarët e Senatit Akademik në institucionet publike të arsimit të lartë;
- c) zgjedh drejtuesin e njësisë kryesore në institucionet publike të arsimit të lartë;
- ç) krijon dhe zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësisë kryesore.

Neni 16
Komisionet e përhershme

Komisionet e përhershme në Universitetin "Eqrem Çabej" janë:

1. Komisionet e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme (KSCB) për cdo Fakultet.

Komisionet përbëhen nga 5 anëtarë nga të cilët 4 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen respektivisht nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj dhe studentët me kohë të plotë të njësisë kryesore për përfaqësuesin e tyre, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur yakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për KSCB. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërritet zgjedhjet për anëtar të KSCB, i cili do të ushtrojë denën për pjesën e



mbetur të mandatit. Funksionet kryesore të këtyre komisioneve lidhen me garantimin e standardeve të cilësisë së institucionit si në aspektin akademik dhe në atë administrativ. KSCB i kushtojnë një vëmendje të veçantë procesit mësimor për cdo program studimi, rezultateve akademike të studentëve dhe marrëdhënieve të tyre me personelin akademik.

Në ushtrim të këtyre funksioneve KSCB harton rekomandime drejtuar autoriteteve apo organeve drejtuese, sipas natyrës së problematikës të konstatuar, mbi parregullsitë e vërejtura së bashku me propozimet përkatëse. Në rast se pavarësisht këtyre rekomandimeve situata nuk ndryshon, KSCB vë në dijeni sipas rastit Këshillin e Etikës, Senatin Akademik dhe Rektorin për marrjen e masave përkatëse.

Minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor të vitit akademik, KSCB-të nxjerrin rekomandim mbi standartet e cilësisë në njësinë kryesore përkatëse.

Rregulla të detajuara të funksionimit caktohen në rregulloren e brendshme te KSCB.

2. Komisioni i dhënies së gradës shkencore "Doktor" (Komisioni Doktoral) për cdo Fakultet.

Komisionet përbëhen nga 5 anëtarë.

Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore përzgjedh nga personeli akademik i njësisë kryesore përkatëse anëtarët e Komisionit Doktoral. Ata mbajnë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Komisionin Doktoral. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërrret zgjedhjet për anëtar të komisionit, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

Organizimi dhe funksionimi i komisionit caktohet në rregulloren e brendshme sipas akteve nënligjore.


3. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik (Komisioni i Profesoratit).

Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Senati Akademik përzgjedh nga personeli akademik i njësive kryesore anëtarët e Komisionit të Profesoratit. Ata mbajnë titullin "Profesor" dhe vetëkandidohen. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Komisionin e Profesoratit. Kur nuk ka të tillë, Senati shpall vakancën dhe zgjedh anëtarin e ri nga personeli i vetëkandiduar, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.

Organizimi dhe funksionimi i komisionit caktohet në rregulloren e brendshme sipas akteve nënligjore.





Neni 17
Bordi i Administrimit

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ i universitetit, i cili garanton mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi përbëhet nga 7 anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme.

Anëtarët, përfaqësues të UGJ-së, vetëkandidohen ose propozohen nga njësitat bazë dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit.

Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin ose e njësisë së qeverisjes vendore emërohen nga titullarët përkatës.

Nëse institucioni siguron vetë pesëdhjetë për qind ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të UGJ-së dhe tre janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe katër janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur njësia e qeverisjes vendore, në territorin e së cilës zhvillon veprimtarinë institucioni i arsimit të lartë, kontribuon finanziarisht, së paku në masën prej dhjetë për qind të buxhetit afatmesëm të IAL-së, atëherë një prej përfaqësuesve, që i takon ministrisë përgjegjëse për arsimin, përcaktohet nga njësia e qeverisjes vendore.

Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit mbaron kur:


- a) përmbushet afati i mandatit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) largohet nga UGJ për përfaqësuesit e vetë.
- d) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi;
- e) bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht për të kryer detyrat e tij;
- f) nuk merr pjesë, për 3 herë rradhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e bordit të Administrimit;
- g) lirohet me akt të Ministrit/Kryetarit të Bashkisë për përfaqësuesit e tyre. Në këtë rast Ministri detyrohet të njoftojë Rektorin 15 ditë përpëra se emërimi i ri të hyjë në fuqi;
- h) vdes.

Administratori i Universitetit ndihmon në përgatitjen e propozimeve dhe materialeve për në Bordin e Administrimit, për të gjitha çështjet brenda përgjegjësive të funksionit të tij.

Mënyra e thirrjes së mbledhjeve, rendi i ditës, pjesëmarrja, votimi, procedurat e votimit dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të Bordit të Administrimit.

Neni 18
Funkcionet e bordit të administrimit





1. Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- a) garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përbushjen e misionit të tij;
- b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- ç) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjeter të arsimit të lartë;
- dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- e) jep mendim për projektrregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- f) është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- gj) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
- h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektori.
- i) miraton propozimin e Senatit për pagat e personelit akademik dhe administrativ si dhe tarifën e orës mësimore;
- j) miraton paraprakisht tarifën e rregjistrimit dhe të studimeve në UGJ dhe ia përcjell për miratim të mëtejshëm Senatit Akademik;
- k) informon Senatin Akademik dhe Rektorin për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë Universitetin.

Neni 19 Rektorati

Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga: a) rektori; b) zëvendësrektori/ët; c) administratori i institucionit; ç) drejtuesit e njësive kryesore. Rektorati në mbledhjet e tij mund të ftojë edhe personel tjeter në varësi të natyrës specifike të çështjes së shtruar për diskutim.

Rektorati ka këto funksione kryesore:

1. diskuton dhe paraqet ne senat projekt-planin e zhvillimit strategjik të institucionit;
2. formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
3. përcakton përparësitë në plotësimin e kërkësave të njësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
4. paraqet rekomandime në senat mbi programet e studimit dhe kërkimit shkençor dñe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;





5.paraqet propozime në senat mbi strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;

6.paraqet në senat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore;

7.paraqet në senat për miratim reportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit;

8.paraqet propozime ne senat mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucionale kombëtarë/ndërkombëtarë;

9.merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të senatit akademik;

10.harton dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të tij;

11. Propozon ne senat kodin e etikes.



Neni 20
Dekanati

Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga: a) dekani; b) zëvendësdekanët; c) administratori i njësisë kryesore; ç) drejtuesit e njësive bazë;

Dekanati ka këto funksione kryesore:

1.koordinon veprimtarinë e njësive bazë të fakultetit;

2.diskuton dhe propozon në rektorat masa për zhvillimin dhe funksionimin e njësisë kryesore;

3.diskuton paraprakisht probleme që lidhen me programet e studimit, kriteret e pranimit në këto programe, shpërndarjen e financimeve dhe përparësitë e zhvillimit;

4.kompetenca më të detajuara caktohen në Rregulloren e Universitetit;

5.harton planin strategjik te zhvillimit të njësisë kryesore.

Neni 21
Këshilli i Etikës

Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e institucionit dhe sidomos në fushën akademike.

Konstatimi dhe shqyrtimi i këtyre çështjeve kryhet me iniciativë ose përmes ankesave të ardhura nga struktura brenda ose jashtë institucionit.

Këshilli i Etikës përbëhet nga tre anëtarë, personel akademik, me të paktën gradën shkencore "Doktor", një për secilin fakultet. Kandidatët për anëtarë vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik, me shumicë të thjeshtë dhe votim të fshehtë.

Nuk mund të zgjidhen në këshillin e etikës personeli akademik i emëruar në poste apo organe drejtuese.





Këshilli i Etikës shprehet me rekomandime drejtuar Rektorit për çdo çështje të marrë në shqyrtim, ku propozohen masat disiplinore dhe veprimet e tjera të nevojshme.
Rektori ka të drejtën e zgjedhjes midis masave të propozuara nga Këshilli i Etikës.

KREU IV AUTORITETET DREJTUESE

Neni 22 Klasifikimi i autoriteteve drejtuese



Autoritetet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" ndahen në autoritete drejtuese akademike dhe administrative.

Autoritete drejtuese akademike janë Rektori, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit.

Autoritete drejtuese administrative janë Administratori i Institucionit, Administratori i njësisë kryesore dhe Administratori i njësisë bazë.

Neni 23 Rektori

Rektori është autoriteti më i lartë akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.

Rektori mban titullin "Prof" dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit ose jashtë tij. Mandati i tij është 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm 1 herë.

Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të njësive kryesore si dhe nga studentët, vota e këtyre të fundit llogaritet në masën 10% të totalit të përgjithshëm të votave.

Rektori në përbushje të detyrës së tij ushtron këto kompetenca:

1. drejton veprimtarinë e UGJ në dinamikën e tij të përditshme;
2. është kryetar i Senatit Akademik dhe ka të drejtën e vetos pezulluese mbi vendimet e tij, duke i kthyer edhe një herë për rishqyrtim në se nuk është dakort me to. Në rast se edhe pas rishqyrtimit, Senati Akademik nuk e ndryshon vendimin, vendimi i Senatit Akademik merr formë të prerë;
3. nënshkruan në emër të Universitetit protokollet e bashkëpunimit të universitetit me Universitete e shkolla të larta të vendit e të huaja, dokumentacionin e anëtarësimit të Universitetit në shoqata kombëtare e ndërkombëtare, si edhe dokumentacionin e bashkëveprimit me fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë;
4. ka të drejtën e delegimit të firmës së vet personave në varësi;
5. është garant i autonomisë universitare të UGJ, si dhe siguron unitetin e institucionit;
6. i kërkon mendim Bordit të Administrimit për çështje të kompetencës së këtij organi;
7. cakton një nga zv/Rektorët për të ushtruar përkohësisht detyrën e rektorit në rast të pamundësisë të përkohshme të rektorit;
8. shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, aktet e Dekanitit.





9. bën propozime për strukturën dhe organikën e detajuar për të gjitha njësitë e universitetit dhe ia paraqet për miratim Senatin Akademik;
10. emëron punonjësit e personelit akademik e ndihmës akademik të brendshëm si dhe punonjësit e personelit administrativ të UGJ, duke iu përbajtur kritereve sipas përcaktimeve të kreut përkatës të këtij statuti;
11. miraton punonjësit akademikë të brendshëm të cilët për vitin akademik përkatës do të jenë nën ngarkesën mësimore të normës, gjithnjë duke vepruar sipas akteve në fuqi;
12. nëshkruan kontratat e punës për çdo kategori të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në UGJ;
13. nënshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë, gradat, titujt dhe çertifikata të tjera zyrtare pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin;
14. zgjidh në mënyrë përfundimtare çështjet e kompetencës mes organeve apo autoritatitëve drejtuese;
15. ushtron kontolle në fakultete, për cilësinë e mësimdhënies, kërkimin shkencor, si dhe çdo çështje tjetër që kanë në kompetencë këto të fundit;
16. ngre komisione të përkohshme këshillimore të cilave u ngarkon detyra të posaçme;
17. jep leje pa të drejtë rroge sipas ligjit;
18. jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e universitetit dhe mund të thërrasë këto forca në rast nevoje;
19. aprovon kriteret e pranimit të personelit akademik, dhe ndihmës akademik në bazë të propozimeve të njësive bazë të institucionit;
20. ngre struktura ndihmëse për zhvillimin e universitetit duke angazhuar stafin akademik, ndihmësakademik,administrativ dhe studentë;
21. interpretion në mënyrë përfundimtare brenda institucionit, statutin, rregulloren apo edhe akte të tjera vetërregulluese që miratohen nga UGJ
22. Rektori i propozon Bordit të Administrimit shkarkimin e administratorit të institucionit.
23. ne ushtrim të kompetencave Rektori shprehet me urdhër.

Mandati i Rektorit mbaron kur:

- a. përfundon afati i mandatit;
- b. jep dorëheqjen;
- c. Në rastet e parashikuara nga pika 10 e nenit 39 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
- d. vdes.

Neni 24 Zëvendësrektori

Rektori në ushtrimin e kompetencave të veta ndihmohet zëvendësrektore.

Zëvendësrektorët i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtarë të OECD-së ose BE-së. Ata janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga rektori pas miratimit në Senatin Akademik.

Kompetencat përkatëse të secilit zëvendësrektor caktohen me urdhër të rektorit.





Neni 25
Dekani

Dekani i fakultetit, është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.

Përveç sa parashikohet në nenin 42 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Dekani ushtron dhe këto kompetenca:

1. i propozon Rektoratit hapjen, mbylljen, reformimin e kurrikulave, të departamenteve apo të njësive të veçanta në fakultet;
2. i propozon Rektoratit hapjen e qendrave, kurseve, ofrimit e shërbimeve të ndryshme për të tretë, pjesmarrjen në projekte brenda apo jashtë vendi, si dhe çdo çështje në lidhje me sa sipër;
3. ushtron kontolle për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës, si dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga departamentet apo personeli i fakultetit;
4. miraton kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të provimit të formimit dhe të mbrojtjes së tezave të diplomave dhe temat e projekt-diplomave;
5. vendos për përashtimin nga UGJ, të studentëve të të gjitha ciklevë të studimit për rastet e parashikuara në Rregulloren e Universitetit;
6. i paraqet kërkesa Rektorit për vende pune së bashku me kriteret kualifikuese;
7. shqyrton programet e studimit të paraqitura nga departamentet përkatëse;
8. emëron përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit;
9. miraton kandidatët fitues për student të përzgjedhur nga departamenti për programet përkatëse;
10. i propozon administratorit të institucionit shkarkimin e administratorit të njësisë kryesore.

Dekani në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me urdhëra.

Mandati i dekanit mbaron kur:

- a. përfundon afati i mandatit;
- b. jep dorëheqjen;
- c. Në rastet e parashikuara nga pika 11 e nenit 39 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- d. vdes.

Neni 26
Zëvendësdekani

Numri i zëvendësdekanëve, emërimi dhe shkarkimi i tyre përcaktohet nga vetë dekani me urdhër.

Zëvendësdekanët janë anëtarë me kohë të plotë të personelit akademik që kanë se përfunduan graden shkencore "Doktor". Kompetencat e zëvendësdekanëve përcatohen me urdhër të dekanit.





Neni 27
Përgjegjësi i departamentit

Përgjegjësi i Departamentit përveç sa parashikohet në nenin 45 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ka dhe këto kompetenca:

1. drejton e kontrollon punën mësimore-shkencore në departament;
2. miraton planet kalendarike, komisionet e provimeve si dhe tezat e tyre;
3. i propozon dekanit komisionet e mbrojtjes së diplomave;
4. drejton punën për diskutimin e ligjëratave dhe teksteve mësimore;
5. miraton programet e lëndëve përkatëse dhe ndjek planifikimin e aktiviteteve shkencore;
6. analizon çdo vit realizimin e detyrave të punës mësimore-shkencore të personelit akademik;
7. propozon në Dekanat për të ftuar personel akademik për periudha semestrale ose një vjeçare të përsëritshme sipas nevojave të departamentit.i propozon administratorit të njësisë kryesore shkarkimin e administratorit të njësisë bazë.

Mandati i përgjegjësit të departamentit mbaron kur:

- përfundon afati i mandatit;
- jep dorëheqjen;
- Në rastetet e parashikuara nga pikë 9 e nenit 42 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
- vdes.

Neni 28
Administratori

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunkcionimin financier të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative përparrë gjykatave dhe institacioneve financiare shtetërore apo private.

Kriteret dhe procedurat e emërimit/shkarkimit të Administratorit parashikohen në ligjin e arsimit të lartë dhe në aktet nënligjore.

Administratori i institucionit përveç sa parashikohet në nenin 52 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ka dhe këto kompetenca:

1. përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Universitetit, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Bordit të Administrimit;
2. përgatit dhe paraqet aktet me natyrë ekonomike dhe financiare për miratim në Bordin e Administrimit pasi kalojnë për diskutim në Senatin Akademik dhe Rektorat sipas rastit;
3. organizon kryerjen e kontroll revizionit financiar të Universitetit;
4. organizon dhe drejton procedurat e marjes në punë të personelit administrativ;
5. i propozon rektorit emërimin, shkarkimin dhe dhënien e masave disciplinare për personelin administrativ;



6. shkarkon administratoret e njesive kryesore dhe bazë pas miratimit të bordit të administrimit.

KREU V ORGANIZIMI I STUDIMEVE



Neni 29 Studimet universitare

Format e studimeve në UGJ janë:

- a) studime me kohë të plotë;
- b)studime me kohë të zgjatur.

Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në programet e studimit një deri në dyvjeçare me karakter profesional, programet e ciklit të dytë "Master profesional" dhe programet e ciklit të tretë "Master ekzekutiv".

Programet e studimit, që jepin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë.

Programet e studimeve si me kohë të plotë, edhe me kohë të zgjatur, organizohen në cikle.

Programet e studimeve propozohen nga departamentet e fakulteteve dhe dekanati i fakultetit ia paraqet ato për miratim Senatit Akademik.

Rektorati shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofrojnë fakultetet e UGJ, para fillimit të aplikimeve për pranime.

Neni 30 Ciklet e studimeve universitare

Programet e studimeve organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme:

- cikli i parë;
- cikli i dytë ;
- cikli i tretë.

1. Programet e Studimeve të ciklit të parë:

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë të jepin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një shumëlojshmëri të gjërë profesionesh e specialitetesh referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen si rregull me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vjet. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer

Në Universitetin "Eqrem Çabej", programet e studimeve të ciklit të parë konceptohen në radhë të parë nga Departamentet e Fakulteteve duke respektuar dhe kërkuesat e dispozitiveve ligjore dhe nënligjore.





Propozimet e departamenteve, shqyrtohen dhe marrin një miratim paraprak në Dekanatin e Fakultetit, i cili ia dërgon programin për miratim Senatit Akademik.

Senati Akademik mund ta kthejë programin e propozuar pranë Fakultetit propozues për rishikim të mëtejshëm. Orientimet e Senatit Akademik janë të detyrueshme për Fakultetin në këtë rast.

Brenda muajit Janar të çdo viti, Senati Akademik finalizon propozimin e tij për kuotat e pranimit në secilin fakultet, duke evidentuar kuotat e pranimit në sistemin e studimeve me kohë të zgjatur.

Brenda muajit Mars, Senati Akademik finalizon propozimet e tij per programet e reja te studimeve.

Brenda muajit janar të çdo viti, secili fakultet , formulon propozimin paraprak për kuotat e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik pasardhës si dhe propozimin për kriteret e veçanta për përzgjedjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kriteret bëhen publikisht të njoitura, të paktën 1 vit para fillimit të pranimeve të studimeve. Këto rradhës në institucion, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi fakultetin përkatës dhe programet që ofron.

2. Studimet e ciklit të dytë:

2.1 Programet e studimit “Master i Shkencave”

Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njojuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim përkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Ato realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.

Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë, si dhe te kene njojuri te njerës prej 5 gjuhëve të huaja të BE sipas përcaktimeve në nenin 76 të Ligjit Nr. 80/2015.

Për hartimin e programeve ndiqen per aq sa eshte e mundur procedurat e ciklit te pare.

2.2 Programet e studimeve “Master profesional”:

Programet e studimeve “Master Profesional” u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë të ciklit të parë, arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional, realizohen me jo më pak se 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në fushën e arsimimit të kryer.

Për hartimin e programeve ndiqen per aq sa eshte e mundur procedurat e ciklit te pare.

UGJ ofron programe studimi në fushën e mësuesisë në përputje me parashikimet e nenit 83 të Ligjit Nr. 80/2015 “Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise”.





3. Studimet e ciklit të tretë:

Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve "Master ekzekutiv", programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programet e studimeve "Master ekzekutiv" ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master ekzekutiv" në fushën e arsimimit të kryer.

Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë specializimi" në fushën përkatëse të programit të studimit.

Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimitaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor". Institucionet e arsimit të lartë vendosin kriterë për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës përvillimin e projektit kërkimor.

Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën "Masteri shkencave" dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga departamentet perkatese në përputhje me standarde shtetërore të cilësisë. Këto kriterë bëhen publike dhe i përcillen QSHA-së, si dhe Ministrisë se Arsimit dhe Sportit.

Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të tretë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare ne përputhje me aktet nënligjore përkatëse.

Neni 31 **Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies**

Studimet në UGJ zhvillohen me bazë vitin akademik i cili organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë në javë.

Neni 32 **Ndjekja e një programi të dytë studimi**

Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve.

Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

Kritere specifike për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.





Neni 33 Transferimet

Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtë cikël studimi, brenda të njëjtë institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

Transferimet lejohen brenda të njëjtë cikël studimi e në fusha studimi të njëjtë ose të përaferta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.

Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e UGJ.

Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në institucionin pritës të arsimit të lartë, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë e institucionit të arsimit të lartë.

Neni 34 Pajisja me diplomë

Me përfundimin e studimeve universitare në Universitetin "Eqrem Çabej" lëshohen këto diploma:

1. Diplomë e ciklit të parë "Bachelor";
2. Diplomë e ciklit të dytë "Master i Shkencave";
3. Diplomë e ciklit të dytë "Master Profesional";
4. Diplomë për gradën shkencore "Doktor";
5. Diplomë specializimi;
6. Diplomë profesionale.

Të gjitha diplomatat e studimeve të ciklit të parë, të dytë apo të integruara, të lëshuara shoqërohen me Suplementin e Diplomës, formati i te cilit miratohet nga Senati Akademik.

Neni 35 Viti akademik sabatik

Personeli akademik i kategorisë "Lektor" dhe "Profesor", me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet e institucionit, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.

Midis personelit akademik dhe Rektorit te Universitetit "Eqrem Çabej" nënshkruhet një kontratë ku rregullohen kohëzgjatja, të drejtat dhe detyrimet si dhe efektet financiare.

Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti kurse specializimi jashtë institucionit.

KREU VI KËRKIMI SHKENCOR





Neni 36
Veprimtaria kërkimore-shkencore

Universiteti "Eqrem Çabej" zhvillon veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese.

Veprimtaritë e kërkimit shkencor në UGJ realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve te hartuara nga departamentet te shqyrtuara ne Dekanat dhe te miratuara nga Rektorati.

UGJ ka të drejtë të hartoje programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 37
Kërkimi shkencor me ose për të tretët

UGJ nëpërmjet strukturave të tij akademike dhe kërkimore, u ofron të tretëve ose pranon ofertë përkim shkencor, ekspertizë shkencore, shërbime e të tjera, duke ndjekur procedurat e miratimit te parashikuara nga neni 36 i ketij statuti dhe kontribon financiarisht sipas marrëveshjeve e në përputhje me Rregulloren e Universitetit.

Kur nga kërkimi shkencor apo shërbimet për të tretët krijohen të ardhura, ato ndahen mes institucionit që ofron shërbimin dhe personelit të përfshirë në të sipas rregullave përkatëse.

Neni 38
Financimi i kërkimit shkencor

Financimi i kërkimit shkencor realizohet me të ardhurat e vetë institucionit, donacione dhe burime të tjera të ligjshme si dhe nga granti i punes kërkimore shkencore që shpërndahet nga AKKSHI mbi bazën e konkurrimit të projekteve.

Universiteti "Eqrem Çabej" përcjell pranë AKKSHI çdo projekt shkencor të ardhur nga njësitet bazë të tij pas vleresimit paraprak nga ana e Rektoratit.

KREU VII
PERSONELI I INSTITUCIONIT

Neni 39
Struktura dhe organika

Senati Akademik në bazë të propozimit të Rektoratit harton strukturën organike për të gjitha nivelet dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e përgjithshëm të personelit.





Neni 40
Personeli efektiv

Personel efektiv është personeli i Universitetit "Eqrem Çabej" i punësuar në bazë të një kontrate pune me kohë të plotë pavarësisht afatit.

Personeli efektiv ndahet në:

- Personel Akademik;
Personel Ndihmës akademik;
Personel Administrativ.

Neni 41
Personeli joefektiv



Personel jo efektiv konsiderohet personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ i punësuar me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në varësi të nevojave mësimore apo administrative.

Gjatë kohëzgjatjes së kontratës së punës ky personel ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si personeli efektiv, me përashtim të parashikimeve të ndryshme në kontratën individuale të punës.

Procedurat e punësimit të personelit joefektiv përputhen me aq sa është e mundur me procedurat e punësimit të personelit efektiv.

Neni 42
Personeli akademik

Personeli akademik në përputhje me rolin dhe veprimtarinë e tij kategorizohet në:

"Profesorë" ku përfshihen titullarët e lëndëve/moduleve dhe udhëheqës të veprimitarisë kërkimore shkencore të cilët zotërojnë tituj "Prof" ose "Prof.asoc" dhe punesohen me kohezgjatje te pacaktuar.

"Lektorë" ku përfshihen anëtarët e personelit akademik me gradën shkencore "Doktor" dhe që kanë jo më pak se 3 vite eksperiencë mësimdhënie në institucionë të arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit, para ose pas marrjes së gradës shkencore dhe punesohen me kohezgjatje te pacaktuar.

"Asistent-lektorë" përfshihen anëtarë të personelit akademik të punësuar me kohëzgjatje të caktuar jo më të vogël se kohëzgjatja e një semestri, të cilët kanë së paku një diplomë "Master i shkencave".

Neni 43
Personeli akademik i ftuar

Njësitë bazë të fakulteteve i përcjellin dekanit propozimin për punësim me kontratë për periudha të shkurtra kohore të personaliteteve vendas/të huaj, studiues ose personel akademik të huaj në kuadër të rritjes së nivelit pedagogjiko-mësimdhënës ose në zbatim të një marrëveshjeje ndërkombëtare.





Njësia përkatëse që kujdeset për marrëdhëniet me jashtë të institucionit pranë Rektoratit ka të drejtë që t'ju propozojë në çdo kohë njësive bazë mundësi të shkëmbimeve reciproke të personelit akademik me universitete vendase apo të huaja ose të punësimit të personaliteteve të huaja.

Dekani i përcjell Rektorit propozimin e njësisë bazë të shoqëruar me mendimin e tij të arsyetur.

Përpara se të vendosë Rektori konsultohet me Administratorin e Institucionit mbi mundësitë financiare të përballimit të kontratës së punës.

Kontrata e punës nuk mund të jetë me afat më të shkurtër se një semester dhe nuk i nënshtronhet procedurave normale të konkurrimit.

Përjashtohen nga zbatimi i këtij nenit rastet e orëve të hapura akademike që mund të zhvillohen nga personalitetë, studiues ose personel akademik vendas apo i huaj në kuadër të bashkëpunimeve ose vizitave të shkurtra akademike.

Neni 44 Personeli ndihmës akademik

Personeli ndihmës akademik është pjesë e njësisë bazë dhe ushtron kryesisht veprimtari mbështetëse në aspektin mësimor, kërkimor dhe zhvillimor.

Personeli ndihmës akademik me urdhër të Dekanit kryen veprimtari mbështetëse edhe për njësi të tjera bazë pavarësisht se nuk është pjesë e tyre.

Personeli ndihmës akademik mund të jetë me karakter mësimor kur realizon veprimtari mbështetëse ekskluzivisht në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si rasti i laborantëve ose personel tjetër i përcaktuar në organogramën e UGJ.

Personeli ndihmës akademik mund të jetë me karakter administrativ kur realizon veprimtari mbështetëse për personelin akademik pa u përfshirë në mësimdhënie. Personel ndihmës akademik me karakter administrativ është personeli i sekretarive mësimore ose personel tjetër i percaktuar në organogramën e UGJ.

Neni 45 Personeli administrativ

Personeli administrativ përfshin specialistët dhe drejtuesit në nivel qëndror (rektorati) ose në nivel kryesor (fakulteti) të angazhuar në drejtimin e përditshëm administrativ, ligjor dhe financiar të institucionit.

Në personelin administrativ përfshihen edhe personeli teknik dhe sanitari sipas organogramës së hartuar nga Senati Akademik.

Neni 46 Procedurat e punësimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik

Punësimi me kohë të plotë i personelit akademik dhe ndihmës akademik kryhet me konkurrim publik, transparent dhe të ndershëm.

Në rast të një vendi vakant për personel akademik apo ndihmës akademik përgjegjësi i njësisë bazë përkatëse pasi merr mendimin edhe të personelit efektiv të kësaj njësie, përgant



kërkesën për shpalljen e konkursit publik duke përcaktuar kushtet dhe kualifikimet që duhet të kenë kandidatët e interesuar.

Kërkesa për shpalljen e konkursit për punësim i përcillet rektorit përmes dekanit të fakultetit përkatës. Në rast se rektori nuk miraton kushtet ose kualifikimet e këruara për vendin vakant, kërkesa i përcillet njësisë bazë përkatëse për tu rishqyrtuar.

Me miratimin e kërkesës për konkurs publik, Rektori përmes strukturës përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore e përcjell për botim kërkesën në Buletinin e Njoftimeve Publike. Kërkesa publikohet edhe në faqen zyrtare të ueb-it të institucionit.

Rektori me urdhër ngrë një komision ad hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant me 5 anëtarë, i përbërë nga Dekani i Fakultetit i cili kryeson komisionin, nga tre anëtarë pjesë e personelit akademik të njësisë bazë përkatëse dhe një anëtar nga Rektorati. Struktura e menaxhimit të burimeve njerëzore mbështet komisionin ad hoc në zhvillimin e procedurave konkuruese.

Secili kandidat i interesuar për vendin vakant, dorëzon brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e konkursit publik, dosjen me dokumentacionin përkatës të inventarizuar, në strukturën e menaxhimit të burimeve njerëzore duke u paisur detyrimisht me një numër protokolli të brendshëm.

Struktura përkatëse e menaxhimit të burimeve njerëzore verifikon formalisht nëse dosja e kandidatit është e plotë në raport me dokumentacionin e këruar në njoftimin e konkursit publik.

Në rast se dosja është e plotë, drejtuesi i strukturës së menaxhimit të burimeve njerëzore lëshon akt pranimi të protokolluar, i cili i vihet në dispozicion të interesuarit brenda 24 orëve nga marrja e tij.


Në rast se dosja ka mangësi, drejtuesi i strukturës së menaxhimit të burimeve njerëzore lëshon akt refuzimi të arsyetur i cili protokollohet dhe i vihet në dispozicion të interesuarit brenda 24 orëve nga marrja e tij. Në këtë rast i interesuar mund të riparaqesi dosjen nëse arrin të rregullojë mangësitë brenda afatit të caktuar për pranimin e dokumentave.

Brenda 1 dite pune nga përfundimi i afatit të pranimit të dokumentave të kandidatëve, struktura e menaxhimit të burimeve njerëzore i përcjell komisionit ad hoc me procesverbal të gjitha dosjet e plota të shoqëruara me numrat e protokollit të marrjes në dorëzim dhe me aktet përkatëse të pranimit.

Komisioni ad hoc brenda 3 ditëve pune nga marrja në dorëzim e dosjeve të kandidatëve, kryen vlerësimin e kandidaturave dhe harton renditjen e kandidatëve. Procesi i vlerësimit dhe i klasifikimit të kandidaturave dokumentohet me procesverbal me numër protokolli të brendshëm të strukturës së menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky procesverbal publikohet menjëherë në ambjentet e institucionit dhe faqen zyrtare të ueb-it.

Procesverbal i mësipërm i përcillet Rektorit i cili shpall fitues kandidatin e renditur të parin.

Struktura e menaxhimit të burimeve njerëzore në bashkëpunim me dekanin dhe përgjegjësin e njësisë bazë hartojnë kontratën e punës e cila nëshkruhet nga kandidati fitues dhe rektori.





Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve pune nga publikimi i procesverbalit të vlerësimit. Ankimi merret në dorëzim nga struktura e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe shqyrtohet nga Rektori brenda dy ditëve pune.

Rektori në rast se pranon ankimin, nuk mund të ndryshojë renditjen e kandidatëve por mund të rihapë përsëri procedurat e konkurrimit. Në këtë rast ngrihet një komision i ri ad hoc.

Urdhëri i Rektorit publikohet menjëherë.

Neni 47

Procedura e vlerësimit të kandidatit për personel akademik dhe ndihmës akademik

Vlerësimi i kandidaturave bazohet në parimet e transparencës dhe meritokracisë.

Vlerësimi dhe klasifikimi i kandidaturave mbështetet në një sistem pikëzimi i cili duhet të përbajë një ekuilibër midis kualifikimeve, eksperiencës dhe rezultateve akademike.

Skema e vlerësimit hartohet dhe miratohet me vendim të Komisionit ad hoc përpara mbarimit të afatit të fundit për regjistrim të kandidaturave. Në rast se nuk vendoset ndryshe përdoret skema si më poshtë:

- Nota mesatare e studimeve universitare x 5 pike
- Nota mesatare e studimeve të gradës shkencore x 5 pike
- Titull akademik x 5 pike
- Vitet e eksperiencës së mësimdhënies / punës x 5 pike
- Cv personale x 1-5 pike, sipas vlerësimit të Komisionit ad hoc

Vlerësimi i mësipërm kryhet nga çdo anëtar i komisionit ad hoc për secilin kandidat. Në përfundim mblidhen pikët e dhëna nga anëtarët e komisionit për të njëtin kandidat dhe hartohet klasifikimi.

Neni 48

Procedura e punësimit të personelit administrativ

Vendi vakant për personel administrativ së bashku me kriteret hartohet nga Administratori i Institucionit në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.

Njoftimi i konkursit publik së bashku me kriteret përcillen për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike

Procedura e vlerësimit dhe e punësimit të kandidaturave për personel administrativ do të jetë e njëjtë për aq sa është e mundur me parashikimet e neneve 45 dhe 46. Për personelin administrativ të ulët si teknik, mirëmbajtës, sanitari etj, konkurrimi mbështetet vetëm në zotërimin e dëshmi/lijensë/certifikatë profesioni kur është e mundur dhe në vitet e punës.





Komisioni ad hoc i vlerësimit në këtë rast kryesohet nga Administratori i institucionit dhe ka në përbërje edhe dy anëtarë të tjera personel akademik ose administrativ të caktuar nga Rektori.

Renditja e kandidatëve i përcillet Rektorit, i cili shpall fitues kandidatin e renditur të parin.

Kontrata e punës formulohet nga administratori dhe nënshkruhet nga Rektori dhe kandidati fitues.

Neni 49
Masat disiplinore

Masat disiplinore që mund të jepen sipas rastit për personelin efektiv të institucionit janë:

Vërejtje me shkrim

Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra

Zgjidhje e kontratës së punës dhe largimi nga detyra

Masa “Vërejtje me shkrim” jepet për shkelje të lehta të normave irregulluese të veprimtarisë së institucionit, të etikës ose të kontratës së punës dhe regjistrohet në dosjen e personelit efektiv. Kjo masë konsiderohet si e padhënë dhe hiqet nga dosja e personelit me kalimin e një afati 6 muaj kur gjatë të cilit personeli efektiv nuk merr një masë tjetër të njëjtë ose më të rëndë disiplinore.

Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” jepet për shkelje të rënda të qëllimshme ose me pakujdesi të rëndë të normave irregulluese të veprimtarisë së institucionit, të etikës ose të kontratës së punës si dhe në rast se brenda një afati 6 muaj personeli ka marrë dy masa “Vërejtje me shkrim”. Kjo masë disiplinore regjistrohet në dosjen e personelit dhe i ruan efektet për një periudhë 1 vjeçare.

“Zgjidhja e kontratës së punës dhe largimi nga detyra i personelit” kryhet për veprime në kundërshtim të hapur me etikën dhe rregullat e funksionimit të institucionit ose kur brenda periudhës një vjeçare personeli është në kushtet e marrjes së një mase të dyte “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”.

Neni 50
Procedura për dhënien e masave disiplinore

Për personelin akademik dhe ndihmës akademik masat disiplinore “Vërejtje me shkrim” dhe “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” jepen nga Rektori me inisiativë ose me propozim të Këshillit të Etikës, Komisionit për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme Mësuanakultetit, Dekanit ose të Përgjegjësit të Departamentit. Propozimi i Dekanit shoqërohet me mendim e Përgjegjësit të Departamentit dhe anasjelltas.



Për personelin ndihmës akademik masa "Zgjidhja e kontratës së punës dhe largimi nga detyra" jepet nga Rektori me iniciativë ose me propozimin e organeve dhe autoriteteve të përmendura më sipër.

Për personelin akademik masa "Zgjidhja e kontratës së punës dhe largimi nga detyra" jepet nga Rektori pas propozimit të Përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit të Komisionit ad hoc të ngritur nga Senati Akademik. Ky komision përbëhet nga 3 anëtarë dhe ngrihet me vendim të Senatit Akademik brenda 1 dite pune nga kërkesa me shkrim e Rektorit. Anëtarët e Komisionit ad hoc propozohen nga Rektori nga radhët e personelit akademik të njësisë kryesore dhe miratohen nga Senati akademik me votim të fshehtë. Në rast refuzimi të ndonjë prej kandidaturave, Rektori propozon kandidature të re ditën e nesërme të punës derisa të plotësohet numri i anëtarëve të Komisionit.

Për personelin administrativ masat disiplinore "Vërejtje me shkrim", "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" dhe "Zgjidhje e kontratës së punës dhe largim nga detyra" jepen nga Rektori me iniciativë ose me propozim të Këshillit të Etikës, Komisionit për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme të Fakultetit dhe Administratorit të Institucionit.

Për Administratorin e Institucionit masat e mësipërme disiplinore propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Bordi i Administrimit. Për Administratorët e njësive kryesore dhe atyre bazë, masat disiplinore propozohen përkatësisht nga Dekani ose Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Administratori i Institucionit me përjashtim të masës "Zgjidhje e kontratës së punës dhe largim nga detyra" e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.

Në çdo rast Rektori shprehet me urdhër të arsyetuar.

KREU VIII STUDENTËT

Neni 51
Statusi i studentit



Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një prej programeve të ofruara nga Universiteti "Eqrem Çabej" dhe vazhdon deri në momentin në të cilin studenti merr diplomën ose certifikatën përkatëse ose kur ai vendos të çregjistrohet përparrë përfundimit të studimeve.

Studenti nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në më shumë se një program studimi me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

Statusi i studentit nuk mund të vazhdojë për një kohëzgjatje më të madhe se dyfishi i kohëzgjatjes normale të programit të studimit. Në rast se kjo kohë tejkalohet Kryesekretari i Fakultetit i propozon Dekanit çregjistrimin e studentit.

Kreditet e grumbulluara nga studenti deri në momentin e çregjistrimit me vendim të Dekanit ose vullnetarisht prej tij, mund të transferohen në rast të rikonkurrit të regjistrimit të studentit në një program studimi të Universitetit "Eqrem Çabej" ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë sipas rregullave përkatëse.





Neni 52
Pezullimi i studimeve

Studenti ka të drejtë që me kërkesë me shkrim të tij të kërkojë pezullimin e studimeve për shkaqe të arsyeshme për një periudhë 5 vjeçare. Në këtë rast kjo kërkesë i përcillet Dekanit i cili me urdhër të arsyetuar pranon ose refuzon kërkesën për pezullimin e studimeve. Në rast refuzimi studenti ka të drejtë të ankohet me shkrim pranë Rektorit, i cili mund të vendosi lënien në fuqi ose ndryshimin e urdhrit të Dekanit.

Në rast të nezullimit të studimeve studenti nuk paguan tarifën e shkollimit.

Studenti që ka pezulluar studimet ka të drejtë që kërkojë rifillimin e tyre me shkrim vetëm në fillim të vitit akademik pa patur nevojë për miratim. Në këtë rast studenti i nënshtronhet tarifës së re të shkollimit të atij viti akademik.

Studenti ka të drejtë vetëm një herë të kërkojë pezullimin e studimeve.

Koha e nezullimit nuk llogaritet përfshirë efektin e kohëzgjatjes së statusit të studentit.

Neni 53

Studentët kanë të drejtë të shfrytëzojnë dhe të përdorin të gjitha burimet akademike dhe materiale të universitetit sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të përgatitjes dhe formimit të tyre akademik-intelektual në përputhje me zhvillimet e tregut të punës.

Me regjistrimin në një program studimi të universitetit, studenti ka pranuar në të njëjtën kohë të gjitha detyrimet e parashikuara në ligjet, aktet nënligjore dhe aktet vetërregulluese të Universitetit “Eqrem Çabej”.

Neni 54
Këshillat studentorë

Studentët kanë të drejtë të organizohen në Këshilla Studentore në rang fakulteti, universiteti dhe në rang kombëtar.

Këshillat Studentorë janë organizime të pavarura të studentëve që kanë për qëllim promovimin e pjesëmarrjes së studentëve në zhvillimin dhe drejtimin e universitetit, të papajtueshme me ushtrimin e veprimtarive politike ose ekonomike.

Këshilli Studentor i Fakultetit përbëhet nga një përfaqësues i secilit grup për çdo program studimi të të dy ciklev. Të drejtën për të qenë përfaqësues grupei ka vetëm studenti me kohë të plotë i cili nuk është anëtar i asnjë grupimi politik.

Përfaqësuesit vetëkandidohen dhe zgjidhen me votim të fshehtë çdo dy vjet nga të gjithë studentët e grupit sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit.

Këshillat Studentorë të Fakultetit përzgjedhin me votim të fshehtë nga radhët e tyre përfaqësuesit në Këshillin Studentor të Universitetit. Numri i përfaqësuesve që përfaqësuesit parashikohen në Rregulloren e Universitetit.



Këshilli Studentor i Universitetit përzgjedh përfaqësuesin/it në Këshillin Studentor Kombëtar sipas parashikimeve në Rregulloren e Universitetit ose në akte të tjera.

Neni 55
Dekani i Studentëve

Me propozim të Këshillit Studentor të Universitetit, Rektori emëron një anëtar të personelit akademik në detyrën e Dekanit të Studentëve.

Dekani i Studentëve luan rolin e koordinatorit në marrëdhëniet midis autoriteteve dhe organeve drejtuese të institucionit nga njëra anë dhe Këshillave Studentorë nga ana tjetër.

Dekani i Studentëve mbështet Këshillat Studentorë në përdorimin sa më efektiv të të drejtave dhe mjeteve në dispozicion të tyre.

Mandati i Dekanit të Studentëve është dy vjeçar.

Veprimtaria e Dekanit te Studenteve rregullohet me vendim të Senatit Akademik.

KREU IX
AUTONOMIA FINANCIARE

Neni 56
Pronat dhe burimet e financimit

Autonomia financiare është kusht për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të lirisë akademike dhe vetëorganizuese të Universitetit "Eqrem Çabej".

Burimet e financimit të universitetit janë:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) pagesat e studentëve për arsimim;
- c) të ardhurat për shërbimet e kryera;
- ç) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
- d) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;
- dh) veprimtari kërkimore-shkencore;

Të gjitha të ardhurat e krijuara nga universiteti përdoren sipas kërkesave dhe nevojave të vetë institucionit dhe pjesa e mbetur mbartet në vitin pasardhës.

Rektorati i propozon Bordit të Administrimit mënyrën e ndarjes së të ardhurave të përfituar nga kryerja e veprimtarive/shërbimeve të institucionit me pjesëmarrjen e personelit akademik.

Universiteti "Eqrem Çabej" ka të drejtën e përdorimit dhe administrimit të pronave të paluajtshme në të cilat zhvillon veprimtarinë duke ruajtur destinacionin e tyre.

Të gjitha pronat e luajtshme përfshirë të drejtën e autorësisë sipas rasteve përkatëse, janë pronësi ekskluzive e Universitetit "Eqrem Çabej".



Neni 57
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i buxhetit.

Rektorati harton dhe përcjell për diskutim në Senatin akademik planin buxhetor afatmesëm i cili miratohet nga Bordi i Administrimit.

Në zbatim të planit buxhetor afatmesëm, njësitë kryesore dhe njësitë bazë i drejtojnë Administratorit të Institucionit propozimet përkatëse për projektbuxhetin e vitit pasardhës brenda datës 30 Qershor të vitit ushtrimor përkatës.

Administratori harton projektbuxhetin të shoqëruar me relacion, dhe e shtron për diskutim në Rektorat.

Rektorati ka të drejtë që me shumicë të thjeshtë votash të bëjë ndryshime në projektbuxhetin e hartuar nga ana e Administratorit të Institucionit. Ky projektbuxhet i përcillet Senatit Akademik, i cili gjithashtu ka të drejtë që me shumicë të thjeshtë dhe votim të hapur të bëjë ndryshime në projektbuxhet.

Përfundimisht projektbuxheti i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

Zbatimi i buxhetit ndiqet dhe kontrollohet nga Administratori i Institucionit i cili është në pozitat e "Titullarit të njësisë publike" sipas kuptimit që i jep neni 4 pika 22 dhe neni 8 i Ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Neni 58
Kontrolli i brendshëm

Senati Akademik ka të drejtën që në strukturën e përgjithshme të institucionit të ngrejë një strukturë të posaçme të kontrollit financiar e cila të ketë si kompetencë ekskluzive mbikqyrjen e veprimtarisë së Administratorit të Institucionit në kuadër të zbatimit të buxhetit vjetor.

Kjo njësi për çdo lloj parregullsie njofton Rektorin i cili mund të iniciojë procedimin disiplinor të Administratorit të Institucionit përpara Bordit të Administrimit.

KREU X
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 59
Miratimi i Rregulloreve

Senati Akademik brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij statuti, me propozim të Rektoratit miraton Rregulloren e Brendshme të Universitetit.

Neni 60
Shfuqizime

Me hyjen në fuqi të këtij statuti, shfuqizohet statuti i mëpashëm i mbrojtuar nga Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.04.2011 me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.





Aktet vetëregulluese të dala në zbatim të statutit të mëparshëm duke filluar nga Rregullorja e Universitetit qëndrojnë në fuqi për aq sa nuk bien ndesh me këtë statut, deri në miratimin e akteve të reja vetëregulluese.

Neni 61
Hyrja në fuqi

Ky statut pasi miratohet përkatësisht nga Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik, hyn në fuqi me miratimin ose heshtjen e Ministrisë së Arsimit me kalimin e afatit 2 mijëra nga data e dorëzimit pranë këtij institucioni.

Gjirokastër më 20.12.2011



ANEKS I
STEMA



ANEKS II
VULA

